



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 15.03.2024

Drejtuar: Znj. Lindita Nikolla
Kryetare e Kuvendit

E nderuar znj. Kryetare,

Në vijim të mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve të datës 12.03.2024 dhe detyrave të lëna në atë mbledhje, lutemi gjeni bashkëlidhur projektvendimet e dakordësuara midis mazhorancës dhe opozitës, lidhur me:

- 1- Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shërbimin publik të Sterilizimit dhe shërbimin publik të Check-up në shëndetësi.
- 2- Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave të sistemit TIMS.

Mbetemi në pritje të njoftimit për mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve.

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

**KRYETARI
GAZMENT BARDHI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. ____/2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT
LIDHUR ME SHËRBIMET PUBLIKE TË STERILIZIMIT
DHE TË CHECK-UP NË SHËNDETËSI**

Në mbështetje të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

VE NDOSI :

1. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shërbimin publik të Sterilizimit dhe shërbimin publik të Check-up në shëndetësi.
2. Komisioni Hetimor ka për objekt të veprimtarisë së tij:
 - (i) Shqyrtimin e çështjeve të lidhura me kontratat publike për shërbimin publik të sterilizimit dhe atë të check-up në shëndetësi, si dhe zbatimin e tyre;
 - (ii) Vlerësimin e nevojës për marrjen e masave administrative apo ndërhyrje ligjore në legjislacionin përkatës.
3. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, vecanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe i respektimit të jetës private të individit.

4. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime për marrjen e masave me karakter administrativ dhe/ose ndryshime të nevojshme ligjore.
5. Komisioni Hetimor do të përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe 6 (gjashtë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe 8 (tetë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste. Përbërja e Komisionit caktohet me vendim të vecantë të Kuvendit.
6. Komisioni Hetimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 4 - mujor, nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevoje, me kërkesë të arsyetuar të Komisionit, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.
7. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni Hetimor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R J A

Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën ____ . ____ . 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

VENDIM

Nr. ____/2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT
PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT TIMS**

Në mbështetje të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

VE NDOSI :

- Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave të sistemit TIMS.
- Komisioni Hetimor ka për objekt të veprimtarisë së tij:
 - Shqyrtimin e çështjeve lidhur me kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të ngarkuara me mbrojtjen e sistemit TIMS; dhe
 - Vlerësimin e nevojës për marrjen e masave administrative apo, ndërhyrjet ligjore në legjislacionin përkatës në fuqi.
- Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, vecanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe i respektimit të jetës private të individit.
- Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime për marrjen e masave administrative dhe/ose ndryshime ligjore.

5. Komisioni Hetimor do të përbëhet nga 15 (pesembëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe 6 (gjashtë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe 8 (tetë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste. Përbërja e Komisionit caktohet me vendim të vecante të Kuvendit.
6. Komisioni Hetimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 4 - mujor, nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevoje, me kërkesë të arsyetuar të Komisionit, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.
7. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni Hetimor.
 - I. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R J A

Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën ____ . ____ .2024